

VENDIM
Nr. 893, datë 21.12.2016

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 914, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 3, të nenit 76, të kreut IX, “Ekzekutimi dhe mbikëqyrja e kontratës”, të tekstit të rregullave të prokurimit publik” bashkëlidhur vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet nënpika, me këtë përmbajtje:

“-objekti i tyre është furnizim me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në varësi të kërkesës së autoritetit kontraktor, të sasisë së përcaktuar të kërkuar, si dhe të çmimit të bursës, sipas Reuters, livruar sipas kushtit CIF-Shqipëri.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi